



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1464/12 prot.

Datë 18.06.2026

V E N D I M
Nr. 832/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 771/2026, datë 09.06.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-80921-04-03-2026, me objekt: “Blerje materialesh pastrimi dhe dezinfektimi”, me fond limit 9,995,839 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 17.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Durrës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, me NIPT (K91624505), me adresë: Fshati Ahmetaq, pranë firmës Ital Kon, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Durrës, me adresë: Rruga “Neki Libohova”, Lagja nr.17, Durrës.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF me NIPT (L42103023G) dhe adresë: Rruga e Qelqit, Zona Kadastrale Nr 3866, Nr Pasurie 310/20 - Kashar 1001, Tiranë.
- Operatori ekonomik “Murati D” SHPK me NIPT (K42003004T) dhe adresë: Rruga Kavajës, Ish - Kombinati Ushqimor, Godinë 1- katëshe, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 09.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 771/2026, datë 09.06.2026, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-80921-04-03-2026, me objekt: “Blerje materialesh pastrimi dhe dezinfektimi”, me fond limit 9,995,839 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 17.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Murati D” SHPK dhe “Besim Kamberi” PF, dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 98 prot., datë 15.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1464/9 prot., datë 16.06.2026, autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Durrës, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 771/2026, datë 09.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-80921-04-03-2026, me objekt: “Blerje materialesh pastrimi dhe dezinfektimi”, me fond limit 9,995,839 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 17.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Durrës.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me anë të shkresës nr. 98 prot., datë 15.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1464/9 prot., datë 16.06.2026, autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Durrës, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 771/2026, datë 09.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-80921-04-03-2026, me objekt: “*Blerje materialesh pastrimi dhe dezinfektimi*”, me fond limit 9,995,839 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 17.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Durrës.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin K.P.P Nr. 771/2026, datë 09.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Durrës, ka zbatuar vendimin K.P.P Nr. 771/2026, datë 09.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-80921-04-03-2026, me objekt: “*Blerje materialesh pastrimi dhe dezinfektimi*”, me fond limit 9,995,839 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 17.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Durrës.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

